

## FIGURA E ALI EFENDI JAKUPIT, SHEMBULLI I MUSLIMANIT TË SHQUAR TË SHEK. XX

*Me këtë shkrim duam të japim një kontribut të vogël për të ndriçuar e njohur Ali efendiun, këtë personalitet të shquar, shkencëtar, dijetar e poliglot të madh të shekullit të kaluar, i njohur e i çmuar në botë, po, çuditërisht, i lënë në harresë nga shqiptarët*

S'ka dyshim se një ndër personalitetet shqiptare më të shquara të fesë islame në shekullin e kaluar ka qenë Ali efendi Jakupi.

Me gjithë punën dhe angazhimin e tij prej alimi, profesori, shkencëtari e prej diplomati, opinionin ynë i gjerë nuk ka pasur rastin që të njihje personalitetin e tij dhe as të shijonte vlerën e punës së tij të palodhur.

Kjo për faktin se Ali efendiu punën dhe aktivitetin e tij prej shkencëtari, alimi e diplomati e ushtroi jashtë atdheut, fillimisht në Egjipt, ku mbaroi studimet, e më vonë në Stamboll, ku jetoi punoi dhe ndërroi jetë.

Ndër shkaqet kryesore pse Ali efendiu vendosi të jetonte e të punonte në mërgim, ose, thënë më mirë, pse vendosi të mos kthehej më në vendlindjen e tij të dashur, pa dyshim, ka qenë aneksimi i Kosovës nga serbët dhe ardhja në pushtet e komunistëve në Shqipërinë pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore.

Ali efendiu i përket atij brezi të të rinjve që ndër të parët nga Kosova kishin marrë rrugën për të kërkuar dituri në universitetin më të vjetër në botë - në "Al-Az'harin" e famshëm të Kajros. Përrpos Ali efendiut, atë kohë në Kajro kanë qenë edhe këta studentë: Hysen Latifi e Muharrem Tahsini nga Gjilani (që më vonë jetuan e vepruan në Xhide të Arabisë Saudite), Hysni Hoxha, Feti Meka, Tefik Islami nga Gjakova, Vehbi Ismaili e Sulejman Gavoçi nga Shkodra<sup>1</sup>.

Pas përfundimit të studimeve në Kajro, shumë studentë të tjerë shqiptarë, po edhe Ali efendiu, meqenëse pushtetin në trojet

shqiptare e kishin marrë komunistët, vendosën të mos ktheheshin, por të organizoheshin dhe kontributin e tyre ta jepnin në diasporë. Kësodore, me gjithë vështirësitë, ata morën mbi supet e tyre misionin për të cilin ishin shkolluar për vite të tëra.

Nga studentë shqiptarë që gjendeshin në Kajro, disa mbetën në Egjipt e të tjerët u shpërndanë në qendra të ndryshme të botës.

### **Biografi**

Ali Jakupi ka lindur më 1913 në fshatin Desivojcë të komunës së Kamenicës. Rrjedh nga një familje e njohur në këtë rreth e më gjerë. Të parët e tij kanë qenë hoxhallarë e alimë me nam, që kanë dhënë një kontribut të çmuar në lartësimin e mësimëve fetare, arsimore e edukative.

### **Familja**

Babai i Ali efendiut, Hysen efendi, ka qenë hoxhë e hafëz i njohur, kurse gjyshi i tij, haxhi Jakup efendi, ka qenë myfti i rrethinës së Gjilanit dhe njeri i respektuar e me ndikim.

Edhe xhaxhai i tij ka qenë hoxhë e hafëz.

Se sa rëndësi i kushtojë atë kohë dijes e shkollimit në familjen e Ali efendiut, më së miri flet edhe kjo e dhënë: të dy motrat e Ali efendiut patën përfunduar *hifzin* (mësimin e Kuranit).

Gjithashtu, edhe dy djemtë e xhaxhait kanë qenë hafëzë dhe myderrizë të njohur<sup>2</sup>.

I pari i familjes së Ali efendiut, Omeri, që i përkiste brezit të tetë, kishte dalë nga fshati Kolgec i Shkodrës dhe ishte vendosur në fshatin Desivojcë, që i përkiste kasabasë së atëhershme të Gjilanit dhe familja edhe sot e kësaj dite mban mbiemrin Shkodra.

Ali efendiut për familjen e tij thotë:

“Nga familja jonë kanë dalë shumë hoxhallarë. Thonë se stërgjyshi, Haxhi Jakupi, ka qenë njeri i mbërrimë. Unë nuk e arrita dot. Edhe të krishterët e njihnin dhe e respektonin. Babai ishte hoxhë dhe hafëz. Ai është edhe mësuesi im i parë i Kuranit. Unë e përfundova përvetësimin e këndimit të Kuranit në moshën 8 vjeç.”<sup>3</sup>

### **Shkollimi**

Ali Jakupi shkollën fillore e kreu në gjuhën serbe në Gjilan. Në të njëjtën kohë, nga babai i tij ka mësuar Kuranin, të cilin e bëri

*hatme* ( e lexoi të tërin) qysh në moshën tetëvjeçare.

Ali Jakupi mësimet e para mbi vlerat e botës dhe jetës i mori nga familjarët, ku u rrit e u edukua me virtytet më të larta islame e kombëtare.

Mësimet në shkollën fillore i ndiqte paradite, kurse pasdite mësonte turqishten. Në këtë moshë, Ali efendiu mësoi përmendsh vjersha nga Mualim Naxhiu dhe Rexhaizade Ekremi.

### **Në medrese**

Pas përfundimit të shkollës fillore në vendlindje, Ali efendiu vazhdon rrugën e të parëve të tij. Më 1924 regjistrohet në medresenë “ATIK” të Gjilanit, ku nga mulla Kadri efendiu dhe nga myderrizi Abdurrahman efendiu mori dituritë themelore deri më 1927.

I pasionuar pas dijes, krahas mësimëve në medrese, te Hasan Faik efendiu mësoi privatisht për krijimtarinë letrare turke dhe mori njohuritë fillestare të gjuhës frënge.

Në revistën prestigjioze të Stambollit “ALTINOLUK”, Ali efendiu e përshkruan kështu jetën në medresenë e Gjilanit:

“Më kujtohet, ngriheshim herët për të dëgjuar ezanin muhammedije. Një orë para namazit merrnim abdest dhe këndonim Kuran. Edhe pas namazit këndonim një xhuz nga Kurani. Të gjitha këto nuk ishin të detyruara, ishin një traditë. Hoxha thirrej myderriz. Ai jepte mësim në klasën e parë e të dytë. Për çdo klasë, nxënësi merrte dëftesë dhe kalonte në klasën më të lartë.”<sup>4</sup>

Pas medresesë së Gjilanit, më 1927 Ali efendiu shkoi në Shkup ku vazhdoi mësimet në medresenë “Meddah” te dijetari i njohur Ataullah efendiu. Po gjatë qëndrimit në Shkup, mori mësim për retorikën dhe letërsinë turke nga myderriz Sejfedin efendiu.

Pas një viti qëndrimi në Shkup, më 1928 kthehet në Gjilan, ku për dy vjet (1928-1929) vazhdon mësimet në shkollën e mesme të qytetit.

### **Në Sarajevë**

Në atë kohë, me propozimin e Shakir Mesihoviçit, anëtar i Mexhlisit të Ylemave në Sarajevë, më 1931 kalon provimin në “Mejtep-Nuvvab” dhe këtu vazhdon shkollimin tre vjet.

Në Sarajevë, Ali efendiu mësoi në shkollën për gjykatës të Sheriatit, e cila qe themeluar nga Austro-Hungaria më 1887. Sipas Kasim Hadžić, nga Kosova ishte vetëm një nxënës-haxhi, Ali Jakupi nga Gjilani, i cili më 1934 kishte ndërprerë shkollimin<sup>5</sup> për shkak të vdekjes së babait, dhe qe detyruar të pushonte për një kohë.

### **Në Kajro**

Pas Sarajevës, Ali efendiu më 1936, i etur për dije, vendosi që t'i vazhdonte studimet jashtë atdheut dhe pikërisht zgjodhi Kajron, respektivisht universitetin e njohur "Al-Az'har", ku përfundoi studimet për Usuli din (Bazat e fesë).

Krahas studimeve që mori në universitetin "Al-az'har", Ali efendiu mori mësim edhe nga dijetarë të njohur të asaj kohe, si ish-Shejhul islami i fundit i Perandorisë Osmane - Mustafa Sabri, pastaj nga Kevtherin Jozgalt, Ihsan Efendi etj.

Ali efendiu në Kajro qëndroi për 20 vjet, fillimisht si student e më vonë edhe si punonjës shkencor në bibliotekën e Universitetit të Kajros, ndërsa dr. Rexhep Boja thotë se një kohë ka punuar edhe në bibliotekën e Aleksandrisë.

Pas përfundimit të studimeve, 11 vjet (1946-1957) ka punuar si nëpunës i lartë në Bibliotekën Qendrore të Universitetit të Kajros.

Ali efendiu, gjatë shkollimit të tij një kujdes të veçantë i kishte kushtuar mësimin të gjuhëve të huaja, përderisa në vendlindje, pos gjuhës amtare dhe gjuhës serbe, turke e arabe, si i ri kishte mësuar edhe gjuhën frënge e, më vonë, kishte mësuar edhe persishten, osmanishten dhe rusishten.

Pos studimeve që mbaroi në fushën e Usulid-dini-it, Ali efendiu, gjatë studimeve në Kajro, në mënyrë të veçantë merrej me specializimin për leximin e teksteve dhe dokumenteve të shkruara në gjuhët osmane, persiane, arabe dhe ruse.

Pa dyshim, jeta e Ali Jakupit në Egjipt nuk qe e rëndësishme vetëm nga veprimtaria e tij si student dhe shkencëtar. Po ajo, edhe më shumë, fsheh një botë të tërë kujtimesh të lidhura me njerëz të rrallë që pati njohur nga veprat ose personalisht.

Në Kajro Ali efendiu u njoh me shumë personalitete nga më të njohurat e kohës në fushën e shkencave islame të Botës Islame.

Mjafton të përmendim bashkëpunimin e Ali efendiut me alimin e njohur Mustafa Sabri, nga i cili që mori mësim edhe u

ndikua më së shumti. Më vonë qe edhe ndër bashkëpunëtorët dhe bashkëmendimtarët më të ngushtë të tij.

Për raportet dhe ndikimin e Mustafa Sabri, Ali efendiu shprehet:

“Pandeh se s’ e teproj po t’ju them se askush s’takohej me të më shpesh se unë! Rregullisht, një herë në javë i shkoja për vizitë në shtëpi. Nga mëngjesi gjer në mbrëmje. Gjer në orën 11 të natës. Më konsideronte si pjesëtar të familjes. Po të shkonte diku, më merrte edhe mua me vete. Më njihte me të tjerët duke u thënë: “Është miku im – (dosti im), adjutanti im!”<sup>6</sup>”

### Ali efendiu për Mustafa Sabri dhe Hasan el-Bena

Për të njohur figurën shumëdimensionale e poliedrike të Ali efendiu, mjafton të shohim mendimet që ai jep për dy dijetarët e njohur, Mustafa Sabri dhe Hasan el-Bena. Vetë njohja e shoqërimi, si dhe bashkëpunimi me personalitete të tilla të Botës Islame, më së miri flasin për thellësinë e mendimit të Ali efendiu. Ai thoshte: *“Mustafa Sabri efendiu ishte një shkencëtar që pati kuptuar botën e sotme, që pati dalë kundër afetarizmit të sotëm, i aftë në gjykim dhe shprehje për t’iu përgjigjur problemeve të kohës! Ai ishte Gazaliu i kohës në emër të Allahut. Ishte një luftëtar!...”*<sup>7</sup>

Ndërsa për Hasan el-Bena pati thënë:

*“Hasan el-Benna ishte njeri i veprimit, tejet praktik. Ngrihej herët, punonte gjer në mesnatë ngrënë a pa ngrënë. Pinte një a dy kafe. Ja, një njeri i tillë. Kur i fliste tjetrit, ia tërhiqte zemrën si magnet. Ishte njeri që ia kishte kushtuar veten Allahut. Sikur Allahu ta kishte krijuar si udhëzues të rinisë së këtij shekulli! Ai e ringjalli rininë universitare. Ai formoi në Kajro një xhemat, bashkësi madhështore!”*<sup>8</sup>

Pas Luftës së Dytë Botërore, Egjipti në përgjithësi, dhe posaçërisht Kajro e Aleksandria, qenë bërë strehë për shumë shqiptarë të ndjekur nga pushteti komunist i Tiranës zyrtare dhe pushteti sllav i instaluar në trojet etnike në ish-Federatën Jugosllave. Kjo për faktin se në Egjipt qeveriste Dinastia shqiptare e themeluar nga Valiu i famshëm shqiptar Mehmet Ali pasha, respektivisht Mbreti Faruk.

Derisa në pushtet ishte Mbreti Faruk, shumë patriotë e antikomunistë shqiptarë gjetën strehim në Kajro, mirëpo me ardhjen e Xhemal Abdul-Naserit në pushtet, gjendja e shqiptarëve në Egjipt vështirësohet, prandaj shumica e tyre detyrohen ta

lëshojnë Egjiptin, ngase ndiqeshin nga pushteti i Abdul-Naserit si përkrahës të Mbretit Faruk. Kjo bëri që edhe Ali Jakupi ta linte Egjiptin.<sup>9</sup>

### **Në Ankara**

Pas 20 vjetësh qëndrimi në Egjipt, respektivisht në Kajro, nga Biblioteka Qendrore e Universitetit "Al-Az'har", Ali efendiu në korrik 1957 mori detyrën e përkthyesit në Ambasadën e Egjiptit në Ankara. Si përkthyes në Ambasadë Ali efendiu punoi deri në nëntor 1959.

Ali efendi Jakupi, pasi heq dorë nga detyra e përkthyesit në Ambasadën egjiptiane në Ankara, më 1960 vendoset në Stamboll, kur mori shtetësinë turke dhe, një vit më vonë, u martua.

### **Në Stamboll**

Koha sa kaloi në Egjipt, për Ali efendiun ishte e ngjeshur me punë e aktivitete nga më të ndryshmet, por brenda vetes së tij rritej dëshira për t'u kthyer afër atdheut, familjes e farefist, mirëpo përderisa një gjë të tillë nuk ia lejonin rrethanat e krijuara në trojet shqiptare, në njërën anë, dhe, në anën tjetër, edhe në Egjipt pas ardhjes së Abul-Naserit nuk pati mundësi që të jetonte me dinjitetin e mëparshëm, Ali efendiu zgjodhi Turqinë, respektivisht ish-kryeqendrën e Perandorisë Osmane, Stambollin, për të jetuar familjarisht këtu.

Prandaj nënën dhe vëllezërit i solli në Turqi. Në atë mes, në Ambasadën e Egjiptit në Stamboll, pati dalë një punë dhe Ali Jakupi pati marrë rrugën e Turqisë, për se në ALTINOLUK është shprehur:

"Po ju them të drejtën! Unë isha i prirë më shumë për në Turqi sesa në Egjipt. Turqia ishte vatani im, or ti! Ç't'ju them, Turqinë e kam parë dhe e shoh si mëmëdhe! Sikur të kisha lindur këtu! Kështu e ndiej. Për shembull, në Egjipt nuk u martova. Mustafa Sabri Efendiu nguli këmbë shumë, por nuk u martova. Madje, kur i shkova për vizitë një ditë para se të vdiste, më tha si me qortim: "Ah, ti, desha të të martoj, por s'u martove!" Sepse e kisha mendjen të vija këtu, or ti!"<sup>10</sup>

Më 1960, alimi e dietari i madh dhe njohësi i 7 gjuhëve të huaja, tani në rrethana të reja, filloi të punonte në një fabrikë private

në zyrën e kontabilitetit, por pa e lënë anash profesionin e tij, atë të hoxhës, kështu që, krahas punës në fabrikë, në xhamitë “Fatih Mesih Pasha” dhe “Emir Buharai” vazhdimisht ligjëronte për veprat, si: Ihya’u ‘ulumi’d-din, edebu’d-dunyya ve’d-din, Medariku’t Tenzil ve Divanu’l Mutenebbi<sup>11</sup>.

Dr. Rexhep Boja, në kujtimet e tij për Ali efendiun, thotë:

“Ali efendiu në Stamboll qe vendosur me shtëpi afër xhamisë “Sulltan Mehmet-Fatih”.

Unë për herë të parë e kam njohur në vitet 1970, pastaj, sa herë që kam kaluar në Stamboll, jam kthyer tek Ali efendiu.

E kam vizituar shpesh, ka pasur një banesë të vogël, ku kishte një bibliotekë të mirë me libra shumë të rëndësishëm, por për fatin e bibliotekës së tij nuk di.

Ali efendiu ka pasur një xhami të vogël afër shtëpisë dhe aty u mbante ligjërata prej librit “Ihja ulumi din”. Ky libër është bazë për themelet e fesë islame, i shkruar në gjuhën arabe e i përkthyer në gjuhën osmane dhe Ali efendiu ua mësonte dhe komentonte studentëve.

Mua më priu fati që një verë të mbetesha në Stamboll. Aty, pos që e takoja çdo ditë atë, pas namazit të iqindisë, së bashku me studentët e Ali Jakupit dëgjoja ligjëratat e tij nga libri “Ihja ulumi din”<sup>12</sup>.

Ndërsa për 4 vjet (1976-1980) ka ligjëruar tefsirin dhe akaidin (retorikën) në Haseki Egitim Merkezi, institucion i Dijanetit (Bashkësisë Fetare të Turqisë) (Diyanet Isleri Baskanligi).

Edhe në shtëpi të vet përgatiste shumë talebe, duke u dhënë mësimet private të interesuarve për arsim të mesëm dhe të lartë<sup>14</sup>.

Megjithëqë larg atdheut, Ali efendiu ndiqte me vëmendje zhvillimin e ngjarjeve në trojet shqiptare. Komunizmin e konsideronte si fatkeqësinë më të madhe të popullit shqiptar, “pa rënë komunizmi, nuk ka hajr për popullin tonë”.

“Komunizmi është e keqja më e madhe, shqiptarët duhet ta kuptojnë se komunizmi është kundër interesave të tyre”.

Vetëm pas rënies së komunizmit, për shqiptarët do të hapet një faqe e re, vetëm atëherë shqiptarët do të bëhen faktorë dhe të zotët e trojeve të tyre që ua kanë marrë fqinjët me dhunë<sup>15</sup>.

Ali efendiun e mundonte shumë prapambetja dhe izolimi i Shqipërisë. “Në kohën kur bota po ecën e po përparon në të

gjitha fushat, si në ekonomi, teknikë e teknologji, në vendin tim mbretëron doktrina komuniste, që është e keqja më e madhe e njerëzimit” - kujton dr. Rexhep Boja shqetësimet e Ali efendiut për Shqipërinë.

Gjithashtu dr. Boja kujton se Ali efendi, megjithëqë ishte i flaktë për Kosovën e Shqipërinë në përgjithësi, ka qenë kategorik: “Sa të jenë komunistët në pushtet, nuk kthehem, se nuk kam ku”.<sup>16</sup>

Ali efendi në Turqi ka qenë i respektuar si në qarqet shkencore, ashtu edhe fetare. E donin dhe e respektonin shumë ulemaja e kohës. Ai konsiderohej alimi e dijetari më i madh i kohës jo vetëm në Turqi, po në tërë Botën Islame<sup>17</sup>.

Se sa rëndësi i kushtohej personalitetit të Ali efendiut në Botën Islame, më së miri flet njësia bibliografike e punuar nga profesori e dijetari i madh turk, i njohur në përmasa ndërkombëtare, prof. dr. Ekmeludin Ihsanogu për “Islam Ansiklopedisi”<sup>18</sup>

“Ali efendi gëzonte respekt të madh nga studentët. Unë i kam parë kur studentët e tij pritnin në rend për t’ia puthur dorën, këtë e bënin në shenjë respekti dhe thoshin se dora e alimit e hoxhës, siç është Ali efendi, ka bereqet”.

Ekmeludin Ihsanoglu, në Enciklopedinë Islame thotë “Librit të Muhamed Kutubit (Xhahiljet kornil ishirn) “Injoranca e shekullit XX”, në dy vëllime, poezinë me titull “Fatih Cami”, që është në librin e parë të sefahateve (botim i plotë i krijimtarisë poetike të poetit të njohur turk me prejardhje shqiptare Mehmet Akif Ersoi), Ali efendi Jakupi e kishte përkthyer në arbishte kur ishte në Kajro dhe përkthimi ishte botuar në revistën “Muccelletu’l-Edeb”.

Në maj 1983, Ali efendi Jakupi qe paralizuar dhe i paralizuar jetoi deri më 22 maj 1988, kur ndërroi jetë në Stamboll, larg vendlindjes së tij.

Ali efendi ndërroi jetë pa shijuar kënaqësinë e rënies së komunizmit në trojet shqiptare. Meqenëse ishte martuar në moshë të shtyrë, nuk ka lënë pasardhës. Është varrosur në varrezat Sakizagoci në Edirnekapi.

Jam i vetëdijshëm që në këtë shkrim të shkurtër nuk mund të përmblihet jeta dhe vepra e një figure kaq të madhe e shumë komplekse, ngase për këtë duhen studime e hulumtime në Stamboll, Ankara, Aleksandri e Kajro, por janë të rëndësishme si burime edhe këto pak të dhëna që na ofrojnë: prof. dr. Ekmeludin

Ihsanogu, në njësinë bibliografike në Enciklopedinë Islame, pastaj dr. Rexhep Boja, i cili pati fatin ta njihje nga afër, si dhe biseda e zhvilluar nga revista ALTINOLUK me Ali efendiu në prill të vitit 1987. Këto të dhëna na japin të kuptojmë sado pak për personalitetin prej shkencëtari, përkushtimin e tij ndaj fesë e atdheut, gamën e gjerë të dijes, thellësinë e mendimit, dashurinë e mallin për atdheun që kishte Ali efendiu.

### Shënime:

- <sup>1</sup> Bisedë me dr. Rexhep Bojen, e zhvilluar më 21 nëntor 2005, në Prishtinë.
- <sup>2</sup> Shih: Ekmeluddin Ishanoglu: Cençikler, Ali Yakup (1913-1988); Islam Ansiklopedisi, Cild 7, Istanbul 1983, sayfa 370-371.
- <sup>3</sup> Shih: Ali Yakup Hoca'nin Hayati (Devanın Asli Ihlas ve Ornek bir hayat); ALTINOLUK, Nisan 1987, Sayfa 13
- <sup>4</sup> ALTINOLUK, Nisan 1987, Sayfa 13
- <sup>5</sup> Kasim Hadžić: Stogodišnjica šeriatske sudačke škole (mejtepi nuvvaba u Sarajevu); Glasnik, br. 5, Sarajevo 1987, st. 664.
- <sup>6</sup> Po aty....
- <sup>7</sup> Po aty...
- <sup>8</sup> Po aty....
- <sup>9</sup> Nga biseda me dr. Rexhep Bojen.....
- <sup>10</sup> ALTINOLUK, Nisan 1987, Sayfa 13
- <sup>11</sup> Ekmeluddin Ishanoglu: Cençikler, Ali Yakup (1913-1988); Islam Ansiklopedisi, Cild 7, Istanbul 1983, sayfa 370-371
- <sup>12</sup> Nga biseda me dr. Rexhep Bojen.....
- <sup>13</sup> Shih: Ekmeluddin Ishanoglu: Cençikler, Ali Yakup (1913-1988); Islam Ansiklopedisi, Cild 7, Istanbul 1983, sayfa 370-371.
- <sup>14</sup> Nga biseda me dr. Rexhep Bojen.....
- <sup>15</sup> Nga biseda me dr. Rexhep Bojen.....
- <sup>16</sup> Nga biseda me dr. Rexhep Bojen.....
- <sup>17</sup> Shih: Islam Ansiklopedisi, Cild 7, Istanbul 1983, sayfa 370-371.
- <sup>18</sup> Nga biseda me dr. Rexhep Bojen.....